

2 Rriten pagat minimale në Gastronomi me 2023 Nevojiten edhe përmirësime të mëtejme

3 Greva feministe në shenjë të AHV/AVS Fushatë në mbrojtje të pensioneve të grave

4 Sindikata Unia e regjionit Cyrih-Shafhauzen Në krye të regjionit u zgjodh Xhaver Sejdiu

Nr. 4 | qershor 2022 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Para 20 vitesh u hoq statuti i punëtorëve sezonal

Kurrë më statut sezonalë – as edhe përmes rrugëve anësore!



Sindikata Unia në krye me drejtuesin e migracionit zhvilloi një aksion senzibilizues për parlamentarë para pallatit federal.

20 vite më parë u hoq statuti mizantropë i punëtorëve sezonalë. Megjithatë, diskriminimi i migrantëve është duke vazhduar më tej. Unia përmes një aksioni para parlamentit rikujton shfrytëzimin e punëtorëve sezonalë – dhe kërkon qëndrim të sigurtë për punonjësit pa pasaportë zvicerane.

Hilmi Gashi

Nga viti 1931 deri më 2002 në Zvicër vliente statuti sezonal. Kështu edhe u krijua një kategori e fuqisë së diskriminuar punëtorë pa qëndrim të sigurt, të cilët kryenin punë të rrezikshme e të rëndë fizike me pagë të ulët. Statuti sezonalë i mundësonte Zvicrës që migracionin t'ia përshtatë nevojave të tregut të vet të punës. Për çdo vit punëtorët sezonalë kishin të drejtë të punonin për më së shumti 9 muaj në Zvicër dhe më pas përsëri për tre muaj të linin Zvicër. Ata kryenin punë të rënda nëpër kantieri ndërtime, në gastronomi, në industri, në bujqësi dhe shpesh banonin në periferi vendbanimesh nëpër baraka, shumë larg familjeve të tyre. «Nuk ishte kohe aspak e mirë» kujton Antonio Ruberto, i cili për vite të tëra ishte si punëtorë sezonal në Zvicër. Më së vështiri kjo kohë ishte për të gjithë ata, të cilët kishin lënë gratë dhe fëmijët e tyre në atdhe. «Ata nuk kishin të drejtë të merrnin me

veti në Zvicër. Kjo ishte jo njerëzore». Kësaj duhet shtuar edhe paqartësinë e pasigurinë: «Unë në fund të sezonit nuk e dija se a do të guxoi prapë të punoi në Zvicër dhe shihja për çdo ditë postën në vendbanimin tim të atëhershëm në Itali, se a ka ardhur viza për sezonin tjetër».

Politika e migracionit diskriminon edhe më tej punonjësit

Përkundër shumë përparimeve, që pruan me veti liria e lëvizjes së lirë me BE-në dhe masat shoqëruese – kemi edhe shumë përkeqësime. Kështu për të ashtuqajturit shtetas të shteteve të treta vlejné edhe më tej kontingjentet. Edhe këto lejohen vetëm për punët e kualifikimeve të larta. Si pasojë janë punonjësit klandestin në profesionet e pakualifikuara. Gjithashtu edhe shtetasit e BE-së, të cilët janë në Zvicër me një leje të shkurtër qëndrimi, gjinden në një situatë të pasigurt.

Përpos kësaj të gjithë migrantët me rastin e vështirësive personale e financiare mund të humbin të drejtën e qëndrimit. Kjo nuk ishte kështu as në kohën e punëtorëve sezonal. Kushdo që aso kohe arrinte të merrte lejen e përhershme të qëndrimit, pas 15 vitesh kishte një qëndrim relativisht të sigurtë në Zvicër. Kjo sot nuk është më e sigurtë. Këtë situatë të padinjitetshme, parlamenti sa më shpejtë duhet ta mënjojë. Kushdo që më shumë se 10 vite pandërprerë dhe në mënyrë të rregullt ka qëndrim në Zvicër, duhet të ketë siguri mbi statusin e qëndrimit, ashtu siç kërkon edhe nisma aktuale parlamentare e deputetes nacionale Samira Marti. bit.ly/3zjs3mq

Kërkohet ndjeshmëri më me madhe politike

Me një aksion para pallatit federal dhe me fletëpalosje Unia tërhoqi vëmendjen e parlamentarëve, që edhe

pas 20 viteve të përfundimit të statutit të punëtorëve sezonal, ka mbetur edhe shumë punë për tu bërë. Dinjiteti dhe integriteti i të gjithë njerëzve, pavarësisht statutit të tyre të qëndrimit, duhet të respektohet. Posaçërisht duhet dhënë fund situatave të qëndrimit, të cilat bëjnë të lëndueshëm punëmarrësit dhe hapin dyer për shfrytëzim dhe dumping social. Përndryshe kërcënojnë që përmes rrugëve anësore të kthehemi në situatë të statutit të punëtorëve sezonal.

«Ajo që unë kam përjetuar si punëtor sezonal nuk ishte aspak e mirë dhe këtë nuk ia dëshiroi askujt» thotë Antonio, i cili së bashku me persona tjerë të besuar ishte pjesëmarrës në aksionin në fjalë të sindikatës Unia.

Rezoluta e Unia: bit.ly/3MuD9rF

Editorial



Të luftohet pabarazia

Futja e lëvizjes së lirë të personave ka përmirësuar pozicionin ligjor të punëtorëve migrantë në vendet e BE/EFTA. Falë marrëveshjes dypalëshe me BE-në, kjo arritje e rëndësishme e politikës së migracionit u fuqizua edhe nga Zvicra. Lëvizja e lirë e njerëzve dhe masat shoqëruese (FlaM) kanë fuqizuar në masë të dukshme të drejtat e migrantëve nga BE në Zvicër. Mjerisht kjo nuk ndodhi edhe me migrantët nga shtetet e treta. Sikur në kuadër të BE-së, ashtu edhe në Zvicër u krijuan dy kategori migrantësh, në njërin ata që përfitojnë nga lëvizja e lirë dhe në anën tjetër ata që lejohen të hyjnë vetëm nën kushte kufizuese dhe me të drejta të kufizuara. Me këtë rast duhet thënë se Zvicra këtë model dy-klasësh e kishte futur qysh në vitin 1990, kur qeveria federale vendosi që të lejohet rekrutim fuqie punëtorë përjashtimisht vetëm nga hapësira e EU/EFTA. Grupet e personave nga vendet e ish Jugosllavisë dhe Turqisë nuk u lejuan me tej – përjashtoj kontingjentet e profesioneve me kualifikime të larta. Kjo situatë detyroj shumë ish punëtorë sezonal që përmes rrugëve të tjera të sigurojnë qëndrimin e mëtejshëm në Zvicër. Kështu u krijuan edhe shumica e SansPapiersve asokohe. Ashpërsia e politikës ndaj të huajve krijon shumë pabarazi e padrejtësi. Prandaj duhet ta luftojmë së bashku çdo trajtim të pabarabartë të njerëzve, duke u angazhuar për një Evropë gjithëpërfshirëse. Të drejtat e njeriut janë të pandara dhe të drejtat e migrantëve janë të drejta njerëzore. Kemi shumë për të bërë dhe ne duhet të mbetemi azhur!

Osman Osmani

News

Uber më në fund duhet të garantoj pagesën në sigurimet shoqërore dhe të punësuarve

Sindikata Unia përshëndet vendimin e gjykatës federale, që përfundimisht vërteton, atë që Unia përfaqëson që sa vite: Shofer:et e Uber dhe furnizues:et e Uber East janë të punësuar të rregullt me të gjitha detyrimet, të cilat ato përmbajnë në veti, përfshi edhe nënshtrimi i një K-KKP në gastronomi. Unia pret nga federata dhe kantonet, që të ndërmarrin masa ndikuese, pasi Uber duhet t'ua kthejë qindra milionat që ua ka borxh sigurimeve shoqërore dhe të punësuarve. Në rast të ndalimit të aktivitetit të Uber në Kantonin e Gjenevës, autoritetet duhet të ndërmarrin masa për të mbrojtur të punësuarit e Uber.

Mbrojtja e pagave me rëndësi qendrore, nevojitet zbatim i ashpër

Zvicra ka pagat më të larta në Evropë dhe në të njëjtën kohë një nga tregjet më të hapura të punës. Prandaj, punëmarrësit në Zvicër janë veçanërisht të varur nga mbrojtja e efikasë dhe pagave. Raporti për masat shoqërore (FlaM) tregon domosdoshmërinë e mbrojtjes së pagave. At ku bëhen kontrollat, zbulohen edhe shkelje. Në vitin e kaluar kontrolloret e kontrollorët kanë shqyrtuar 140 000 paga. Çka është e vërteta sikur edhe më parë ka edhe më tej shumë hendeqe në FlaM. Fjala bie vetëm gjysma e të punësuarve i kanë të mbrojtura pagat minimale me KKP. Kantone të ndryshme kontrollojnë pamjaftueshëm dhe janë mjaft tolerant kundrejt dumpingut. Këto hendeqe në mbrojtjen e pagave duhet të mbyllin.

Statistikat e Sekretarit Ekonomik Shtetëror mbi papunësinë më maj 2022

Numri i të papunëve në Zvicër në muajin maj është zvogëluar më tej. Për herë të parë që nga vjeshta 2019, ju duhet më pak se 100 000 personave të lajmërohen për të kërkuar punë. Kjo për punëmarrësit në Zvicër paraqet një zhvillim pozitiv. Kjo pasqyron edhe zhvillimin e mirë ekonomik. Mirëpo, mjerisht të moshuarit 60 deri 64 vjeçar nuk kanë ndier këtë zhvillim. Kjo grup e të moshuarve aktualisht ka nivelin më të lartë të papunësisë. Numri i të papunëve në ndërkohë është më i madh se sa në kohën e krizës së koronës. Reagimi i BSZ (Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës): Në qendrat rajonale duhet të rriten përpjekjet për integrimin e të papunëve të moshuar. Federata u venë në dispozicion qendrave ndërmjetësuese të punës përmes «Impulsprogramm» të vitit 2019 më shumë se 60 milion franga në vit, për të ndërmjetësuar të papunët e shtyrë në moshë.

Tregtia-online: Ndërmarrjet nuk marrin përgjegjësinë përsipër!

Një raport i Public Eye, një organizatë partnere e Unia, tregon se të 10 platformat më të njohura për tregtim online të modës nuk merakosen fare në respektimin e normave sociale e ekologjike. Është koha që federata të fuqizojë mekanizmat sigurues ligjor – për një tregtim mode transparent dhe me vetëdije përgjegjësie! Andaj, Unia mbështet apelin e Public Eye drejtuar parlamentit. Për këtë nevojitet me sa vijon: Detyrimi për respektimin e të drejtave të njeriut, përfshi edhe pagesa e pagave ekzistenciale si dhe transparencës, që të pengohet shfrytëzimi dhe të bëhet e qartë se në cilat fabrika janë duke u prodhuar teshat apo këpucët; ndalesë shkatërrimi të prodhimeve të reja, për të mos përfunduar në mbeturina mallrat e kthyerat dhe ato të mbetura; mbrojtje më të mirë ligjore dhe kontrollat në logjistikë, për tu respektuar të drejtat në punë dhe për të luftuar kushtet e pasigurta të punës.

Mbështete edhe ti apelin publiceye.ch/de/was-sie-tun-koennen/aktion/unbox-fair-fashion



Pagat minimale në gastronomie rriten ne vitin 2023 Nevojiten edhe përmirësime tjera

Pagat minimale në gastronomie do të ngritën në vitin 2023. Do të kompensohet shtrenjtimi dhe përtej kësaj do të ngritën pagat minimale varësisht nga shkalla e pagës deri në 40 franga në muaj.

Hilmi Gashi

Partnerët kontraktues të Kontratës Kolektive e Kombëtare të Punës të Gastronomisë (K-KKP) janë pajtuar për kompensimin e shtrenjtimit duke shtuar edhe rritjen e pagës minimale prej deri në 40 franga në muaj.

Nevojiten përmirësime të mëtejme

Rezultati i bisedimeve është diskutuar në mënyrë kontroverze në konferencën sektoriale të Unia. Për ironi, në nivelin e punonjësve pa diplomë jepet vetëm kompensimi i shtrenjtimit. Pas dy vitesh pandemi korone me kufizime, pasiguri, dhe ngarkesa shtesë kjo është mjaft problematike. Andaj rezultati është një shans i humbur dhe aprovimi nga ana i delegatëve të Unia ishte i ngushtë. Ata presin nga shoqatat e punëdhënësve negociata të reja, për t'ju rrekur problemeve të shumëllojshme në degë.

K-KKP duhet të vlejë deri në fund të vitit 2023

Kontrata e vlefshme Kolektive e Punës duhet sipas vullnetit të partnerëve social të zgjatet deri në fund të vitin 2023. Ata kanë parashtruar para SECO-s (Sekretariatit

Shtetëror për Ekonomi) zgjatjen e vlefshmërisë së përgjithshme (AVE/DFO). Me AVE/DFO punëmarrësit e sektorit edhe më tej do të përfitojnë nga mbrojtja që u ofron K-KKP. Në ndërkohë do të ri negociohet K_KKP e re. Unia me rastin e nego-

ciatave mbështetet në kërkesat e Manifestit «Ne duam të jetojmë në dinjitet!» (ne kemi raportuar për këtë manifest në Horizontet 3/2022), të cilin manifest në muajin prill e kanë nisur të punësuarit në gastronomi. Vega e Manifestit: bit.ly/3MuIWxq

Pagat e reja minimale nga 1 janari 2023

Shkalla e pagës	2022	2023
Punonjësit pa diplomë profesionale	3477.–	Kompensimi i shtrenjtimit
Punonjësit pa diplomë profesionale, me Progresso-Attest	3682.–	Kompensimi i shtrenjtimit plus 10.–
Punonjësit me certifikatë federale profesionale, ose të ngjashme	3793.–	Kompensimi i shtrenjtimit plus 20.–
Punonjësit me certifikatë federale të aftësisë, ose të ngjashme	4203.–	Kompensimi i shtrenjtimit plus 40.–
Punonjësit me certifikatë federale të aftësisë, dhe trajnim të mëtejme	4304.–	Kompensimi i shtrenjtimit plus 40.–
Punonjësit me provim profesional	4920.–	Kompensimi i shtrenjtimit plus 40.–
Praktikanten dhe praktikantët	2216.–	Kompensimi i shtrenjtimit plus 20.–



Pamje nga aksioni i sindikatës Unia në mbështetje të punonjësve të gastronomisë për kushte më të mira pune

KKP me Smood pa korrier:et dhe sindikatën e tyre Unia

Praktikat e diskutueshme sindikaliste

Syndicom dhe Smood, ndërmarrja për dërgesat e vakteve dhe blerjeve, kanë negociuar një Kontratë Kolektive të Punës (KKP). Syndicom nuk ka marrë mundimin që të përfshijë në këtë proces as sindikatën Unia e as kurir:et grevistë, pa të cilët kjo megjithatë nuk do të ishte mundësuar.

Èvènement syndical 01.06.2022, përshtatur nga Marie Saulnier Bloch

Korrier:et kishin kohë vetëm pak orë , për të thënë Po apo Jo. Pa mundësinë, që të diskutojnë mbi këtë dhe pa garancinë, që votimi i tyre do të trajtohej me besueshmëri. Bëhet fjalë për një procedurë jodemokratike, e cila bie ndesh me të drejtën dhe lirinë e organizimit. KKP vërteton kushtet aktuale dhe çalon shumë më prapa se rekomandimet e Dhomës së Gjenevës për Marrëdhënie Kolektive të Punës. Risi është, që punëdhënësi obligon të punohet së paku dy orë përnjëherë dhe së paku katër orë në javë. Më këtë njeriu nuk mund të paguaj faturat. Më tej KKP parasheh një model jofleksibël të orarit të punës, i cili lehtëson bartjen e rrezikun e ndërmarrjes tek punëmarrësit. Megjithatë, mund të ketë një ndikim pozitiv te korrierët e punësuar nga Simple Pay nëse do të mund të përfitonin nga kjo. Smood përdor këtë nënkontraktor, i cili në kundërshtim me Ligjin e Punës paguan korrierët për minutë.

Kjo KKP, drejtorit ekzekutiv të Smood, milionerin Marc Aeschli-mann i shkon shumë për shtati. Pasiguria e skajshme të cilës i nënshtrohen korrier:et, është një problem për myshterintë dhe për imazhin e aksionarëve dhe të partnerëve kryesor, Migros-in. Me KKP tani duhet të tregoi se i përmbahet ligjit. Syndicom

paraqet një garanci për këtë larje sociale. Dhe përderisa këto nuk mbulohej nga Simple Pay, atyre nuk u kushton GAV asgjë. Në ndryshim nga korrier:et, që u zbritet 0,25% e pagës si kontribut në kostot e zbatimit të KKP. Megjithatë, parashikohet që anëtarët e Syndicom të përjashtohen nga kjo taksë. Ata, anëtarë e të cilëve tek Smood mund të numërohen me gishtat e njëjës dorë, mund të shpësojnë për një rritje të caktuar anëtarësimi.

Duke pasur parasysh situatën e pasigurt në ekonominë e platformës dhe vështirësinë e organizimit të punëtorëve atje, sindikatat duhet të bashkohen ose të paktën të mos qëllonjë njëri-tjetrin pas shpine. Sjellja e Syndicom ngre pyetje të caktuara. Duhet të qartësohet se përgjegjës për këtë është vetëm drejtoria ekzekutive. Sigurisht, punonjësit e postës e telekomit, printerë e gazetarët apo librashitësit, të cilët përbëjnë këtë sindikatë, nuk janë të përfshirë në këtë çështje.

Fushata e AHV/AVS

Greva feministe në shenjë të AHV/AVS

Me 14 qershor do të zhvillohet grevë për çështje feministe. Sivjet vëmendja përqendrohet tek revidimi i sigurimit të pensioneve të pleqërisë AHV/AVS, i cili në vjeshtë do ti nënshtrohet votimit popullor dhe i cili si i tillë paraqet një sulm kundrejt pensioneve të grave.

Sarah Heinzmann

14 qershori i vitit 2019 mbetet me mall në kujtesë. Qindra mijëra gra kanë zhvilluar grevë dhe kështu kanë shtruar në rrugë kërkesat e tyre për kushte më të mira jetese e pune. Që nga kjo kohë kemi përparime formale: pjesa e grave në parlament është rritur dhe edhe pushimi i ertëve si dhe edhe Martesa për të Gjithë është fuqizuar me ligj.

Megjithatë lufta nuk është fituar ende: Gratë për punë të njëjtë fitojnë edhe më tej 20% më pak dhe kryejnë më shumë punë të papaguar se sa burrat. Në disa degë kërcënojnë deri edhe përkeqësime të politikave gjinore: Parashtrësja e AHV/AVS, të cilën e ka vendosur parlamenti, një parashtrësë kjo reduktuese në kurriz të grave. Ky revidim paraqet një sulm frontal kundrejt pensioneve të grave në Zvicër: moshë e pensionit të grave duhet të rritet, mirëpo jo edhe pagat e pensionet. «Është skandalozë, për të marrë më pak pension për një vit dhe në të njëjtën kohë me punuar më gjatë» thotë Aude Spang, sekretare për barazi në Unia. Në vend të rritjes së moshës së pensionit për gratë, ajo kërkon pensione më të larta. Forcat e djathta borgjeze në të kundërtën tek AHV/AVS 21 shohin një hap drejt barazisë, pasi moshë e pensionit për gratë barazohet me atë të burrave – gjë që fare nuk qëndron! Në jetën e

punës gratë për punë të njëjtë janë të paguara më keq se sa burrat dhe kryejnë shumë punë të papaguara. Aktualisht ato marrin 1/3 më pak pension dhe përmes kësaj janë më të prekura nga varfëria në moshë të shtyrë. Para se këto parregullsi të mos përmirësohen, rritja e moshës së pensionit nuk kontribuon për më shumë, por për më pak barazi.

Kundër parashtrësës AHV/ASV do të mbahet referendum. Për një kohë të shkurtër janë grumbulluar tri herë më shumë nënshkrime se sa janë nevojitur – kjo tregon, se sa në kundërshti ka hasur parashtrësja tek popullata. Në shtator do të votohet për parashtrësën në fjalë. Fushata për referendum do të jetë në qendër të vëmendjes me 14 qershor: Greva feministe do të zhvillohet tërësisht në shenjë të pensioneve të pleqërisë. «Një fushatë e tillë nga pikëpamja feministe është e domosdoshme» thotë Aude Spang. «Gratë borgjeze dhe e djathta konservatore përpiqen të lejnë përshtypjen, se kjo është në kuptim të barazisë, që gratë dhe burrat të punojnë deri në moshën 65 vjeç. Andaj sindikatat dhe kolektivet greviste duhet që me 14 qershor të mobilizojnë të gjitha gratë dhe jo vetëm ato që përfaqësojnë klasën e privilegjuar!».



Pamje nga një aksion feminist ku u kërkuar pensione më të larta në vend të rritjes së moshës së pensionit

Konferenca mbi BE-në: Perspektivat evropiane të lëvizjes sindikaliste Bashkëpunimi për një Evropë sociale

Pas dështimit të marrëveshjes kornizë me BE në maj 2021 sindikatat kërkuar një ndryshim paradigme në politikën evropiane. Zvicra duhet të kontribuojë për një Evropë sociale dhe të ndërtojë një marrëdhënie të qëndrueshme me Evropën, e cila duhet ndërtuar bashkë në interes të punëmarrësve. Konferenca e Unia me 11 qershor trajtoi pyetjen se si këtë mund ta specifikojmë më tej nga perspektiva sindikaliste.

Marília Mendes

Kah po lëviz Evropa?

Përgjatë viteve në BE është duke dominuar një politikë neoliberale. Në Konferencën e Unia mbi BE-në profesoresha e së drejtës Sacha Garben tregoi se në vitet e fundit BE ka ndryshuar dhe se është duke lëvizur me fuqishëm drejtë drejtësisë sociale. Edhe pse jo me detyrim, rezultatet e Samitit Social të mbajtur në Porto në 2021, vendosën themelet për shtyllat e të drejtave sociale. Samiti në fjalë aprovoi një plan aksioni, për të luftuar varfërinë në Evropë dhe për të mundësuar arsimimin e mëtejshëm të shtetaseve të BE-së dhe kështu për të fuqizuar mobilitetin profesional të tyre.

Kontributi i sindikatave

Roland Erne, profesor për integritet evropiane dhe marrëdhënie pune në Dublin,

tregoi me shembullin e iniciativës qytetare evropiane, se si mund të vendosen preokupimet e punëmarrësve në rrafshin më të lartë.

Pas tij Lorenzo Rapetti, nga Bashkimi i Sindikatave Evropiane (EGB) tregoi se si sindikatat në një bashkëpunim të koordinuar në nivelin e BE-së ia arrijnë të ndryshojnë iniciativën e BE-së për pagë minimale ashtu që të fillojnë bisedimet për KKP dhe të fuqizohen sindikatat.

Çka domethënë kjo për Zvicrën

Tryeza e diskutimit e pasdites ua bëri të gjithë pjesëmarrësve të qartë se shumëçka është më dinamike dhe se sindikatat dhe e majta mund të lëvizin diçka më shumë në drejtim të Evropës sociale e ekologjike.

Përçarja do të dobësojë shumë të arritura, si fjala bie masat shoqëruese. Kjo do të ishte fatale për punëmarrësit dhe për marrëdhëniet me BE-në.

Në grupet vijuese të punës kjo tematikë u thellua më tej. Nga migrantët pjesëmarrës pritët që në diskutimet në të ardhmen, perspektiva e migrantëve duhet të merren parasysh dhe të zënë vendin e merituar. Në këtë konferencë kjo u përmend vetëm në periferi, gjë që u kritikua si mangësi.

Mbi të gjitha konferenca ishte një pikëpamje interesante mbi Evropën, e cila ofron hapësirë për më shumë bashkë formësim social.

Intervista me Naciye Aktas mbi 14 qershorin



Në shtëpi nuk kam pauzë, pushojë në punë

Naciye Aktas është 45 vjeçare, i ka 2 fëmijë. Ajo punon në një qendër kuruese të një spitali në Gjenvë. Naciye ka ardhur në Zvicër me familjen e saj në moshën 10 vjeçare si fëmijë refugjat. Ajo ka ndjekur 11 klasë shkolle dhe pastaj është martuar si shumë e re me 20 vjet. Burri i saj ka ardhur në Zvicër përmes martesës. Fillimisht ajo donte të studionte për punë sociale dhe ka bërë një praktikë. Pastaj ajo me 22 vjet mbetet shtatzënë dhe ka prurë në jetë fëmijën e saj të parë. Pas lindjes së fëmijës ajo e kishte të pamundur që të përballonte arsimimin dhe kujdesin për fëmijën. Andaj, asaj iu desh të heq dorë nga ëndrra e saj. Ajo donte të bëhej punëto sociale, të mësonte anglishten dhe për këtë donte të shkonte në Angli.

Naciye a nuk ishte e mundur për ty, të jesh nënë dhe të vazhdojë arsimimin?

Jo, ishte e vështirë. Në fillim doja të rrisja vet fëmijën tim, andaj as kam punuar edhe as kam vazhduar arsimimin tim. Unë isha gjithashtu tërësisht e lodhur me përkujdesjen për fëmijën tim dhe punët e shtëpisë. Unë nuk munda të gjej forcë që krahas kësaj të ndiqja arsimimin. Kur djali im mbushi 2 vjet, unë arrita të gjej një vend pune si recepsioniste në një klinikë private. Mirëpo, nuk ishte e thjeshtë që me një fëmijë të punoi 100%. Andaj edhe reduktova punën time në 50%.

Si reagoi punëdhënësi yt me këtë rast?

Ai nuk ishte i kënaqur. Pos kësaj unë nuk kisha edhe mirëkuptim nga koleget e mija të punës. Unë kam përjetuar gjëra të pakëndshme, deri edhe bullizëm. Ato më përjashtojnë. Kur unë i takoj bashkë, ato nuk më ftonin, etj. Presioni nga punëdhënësi dhe mungesa e mirëkuptimit nga koleget e mija më lodhi. Mu desh të lajmërohem e sëmure. Atëherë kam pyetur veten, çka është me rëndësi për mua? Për mua ishin shëndeti im dhe fëmija im me rëndësi, për këtë arsye dhashë dorëheqje nga puna. Për një kohë të caktuar munda të marr kompensimin e mëditjeve të papunësisë dhe pastaj gjeta punën time të tanishme.

Ti ke dy fëmijë, si ishte tek fëmija yt i dytë?

Tek vajza ime, situata e punës sime ishte më e mirë. Unë punoja në një ndërmarrje shtetërore. Ata kishin më shumë mirëkuptim për një nënë. Unë tek fëmija im i dytë kam përjetuar vështirësi tjera. Unë kisha vetëm 1.5 muaj pushim lehonie. Derisa vajza ime ishte e vogël, më duhej të shkoja në punë. Fatmirësisht për vajzën time kujdesej nëna ime. Në të vërtetë unë kisha dëshirë të kisha më shumë kohë për të rritur vajzën time, deri sa ajo të mbushte 3 vjet, sikur në Francë. Atje marrin edhe mbështetje financiare.

Me 14 qershor gratë dalin përsëri në rrugë për më shumë pagë, për barazi të vërtetë. Cilat tema janë për ty me rëndësi?

Më shumë pagë është edhe për mua me rëndësi, mirëpo nuk ka transparencë pagash, andaj unë nuk di kush sa fiton. Më shumë pushim lehonie është e nevojshme!

Puna jonë në shtëpi gjithashtu duhet të njihet si punë dhe të paguhet si e tillë. Unë punoi nga ora 7 deri në mbrëmje në ora 21. Unë zgjohem në ora 7, zijë pastroi, përgatit gjithçka. Në ora 15 filloi me punën e paguar, deri në ora 21. Unë pushojë çka është e vërteta në punë, atje mund të bëjë pauzë, në shtëpi ne nuk kemi pauzë.

Unë e konsideroj të rëndësishëm solidaritetin mes grave. Ne duhet të mbështetemi në mënyrë të ndërsjellët, kur një grua ka vështirësi, ne duhet ti gjendemi pranë. Për këtë arsye është me rëndësi që ne të organizohemi në sindikata dhe në shoqata të migrantëve. Sindikatat dhe shoqatat e migrantëve duhet të bashkëpunojnë me fuqishëm mes veti.

Emine Sariaslan

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Shkarkimi para pensionimit: A kam të drejtë në ndonjë kompensim?

Unë i kam mbushë 62 vjet dhe kam punuar si sekretare për 20 vite në të njëjtën ndërmarrje. Tani ndërmarrja më ka shkarkuar nga puna. Kështu shkurt para pensionimit më është shkaktuar një humbje e madhe në fondin e pensioneve. Për këtë arsye familja ime më ka thënë se unë duhet të ndërmarrë masa kundrejt shkarkimit. A duhet që të më kompensoi ndërmarrja?



DYFISH I DËNUAR: Kushdo që shkarkohet shkurt para pensionimit, do të ketë pasoja të mëdha në pension (Foto: iStock)

Marina Wyss: Jo, jo detyrimisht. Një kompensim mbetet borxh, nëse shkarkimi është abuziv. Ligji numëron një seri shkaqesh, tek të cilat shkarkimi mund të jetë abuziv. Kjo është në rastet kur, punëdhënësi ndërmerre shkarkimin për cilësi personale. Nëse shkarkimi karshi punëmarrësit ndërmerret, pasi ai gjendet para pensionimit dhe kjo qon në humbje të viteve të kontributeve, kjo si arsye e vetme nuk mjafton që shkarkimi të konsiderohet abuziv. Gjyqi shqyrtton se a mos mes interesave të palëve kundërshtuese ekziston një mospërputhje e madhe. Në një vendim të 20 dhjetorit 2005, Gjykata e Lartë Federale në parim pohoi abuzimin me rastin e një shkarkimi. Një punëmarrës kishte punuar për të njëjtën ndërmarrje për 44 vjet radhazi, kur 14 muaj para daljes në pension u pushua nga puna pa paralajmërim. Gjykata federale argumentoi se ndërmarrja bëri shkelje në raport me detyrimin e përkujdesjes. Ky detyrim i përkujdesjes rritet për shkak të periudhës veçanërisht të gjatë të punësimit. Në këtë rast kishte një mospërputhje të madhe interesash. Ndërmarrja duhet t'ia kishte mundësuar punëmarrësin të përfundonte marrëdhënien e tij të punës për kohën e shkurtër të mbetur pa humbje financiare.

Në rastet e shkarkimeve para daljes në pension, këshillohen të gjithë të prekurit që të kërkojnë vlerësim nga Unia. Kujdes: Zbatohen afate të shkurtra!

(Work, 20.5.22)

Shkarkimi para pensionimit: A është e mundur vazhdimi i skemës së pensioneve profesionale?

Unë i kam mbushë 62 vjet dhe mua më kanë shkarkuar nga puna pak para pensionimit. Shkaku i moshës sime sipas të gjitha gjasave e kam të pamundur të gjej një vend të ri pune. Një shoqe më ka thënë se ajo pas shkarkimit nuk ka mbetur e siguruar më tej në skemën e pensioneve profesionale (BVG/LPP). Në vend të pensionit asaj i është paguar një përshtatje e përnjëhershme e kapitalit të kursyer. Unë do të qëndroja edhe më tutje e siguruar në institucionin e pensioneve profesionale. A është kjo e mundur?

Marina Wyss: Po. Me prishjen e marrëdhënies së punës juve në parim u ndërpritet edhe sigurimi i detyrueshëm. Nga 1 janari 2021 megjithatë vlen një dispozitë e re ligjore, sipas së cilës të siguruarit mbi moshën 58 vjeç mund të kërkojnë vazhdimin e mëtejshëm të sigurimit në fondin e tyre të pensionit si në masën e deriatëhershme. Megjithatë, ju duhet t'ia paguani vetë kontributet për të mbuluar rreziqet e vdekjes dhe paaftësisë, si dhe kontributet në shpenzimet administrative. Para përfundimit të moshës 58 vjeçare është i mundur vazhdimi i sigurimit mbrojtës, nëse këtë e parasheh rregullorja e institucionit të skemës pensionale profesionale. Unë ju sugjeroi juve, që ti shqyrtoni me kujdes të madh kondicionet e propozuara nga sigurimi.

(Work, 20.5.22)

Sëmundja: A do të deklarohet si pagë marrja e mëditjes në rast sëmundjeje tek AHV/AVS?

Unë për një kohë të gjatë shkaku i sëmundjes kam qenë i paaftë për punë. Ndërmarrja e ime e atëhershme kishte lidhur një sigurim të mëditjeve në rast sëmundjeje, i cili e lironte nga pagesa e mëtejme e mëditjeve. Pasi unë tanimë kam arritur moshën e pensionit, mësova se shumë e mëditjeve që mua gjatë kohës së paaftësisë nuk ishte deklaruar si pagë tek AHV/AVS. A duhet AHV/AVS të zbriste këtë shumë?

Federica Colella: Jo. Pasi tek paftësia punëmarrësit për një kohë të caktuar kanë të drejtë në pagën e tyre, apo si alternativë në mëditjet e sëmundjes. Varësisht se çka qëndron në kontratën tuaj të punës. Disa Kontrata Kolektive të Punës dhe Kontrata Normale të Punës i obligojnë ndërmarrjet që të lidhin një sigurim të mëditjeve në rast sëmundjeje. Nëse nuk është paraparë në Kontratë, punëdhënësi është i obliguar që të vazhdojë të paguaj pagën gjatë paftësisë për punë. Megjithatë, kohëzgjatja e detyrimit për të vazhduar pagesën e pagës është e kufizuar. Megjithatë, sigurimi i mëditjeve në rast të sëmundjes duhet t'ju japë kompensime ditore që janë të paktën të barasvlershme me përfitimet që do të kishit pasur në bazë të detyrimit ligjor për të vazhduar pagimi i pagave gjatë sëmundjes. Nëse, në të kundërtën, ndërmarrja juaj ka lidhur një sigurim të mëditjeve në rast sëmundjeje, ajo është e liruar nga vazhdimi i pagesës së pagës. Në çdo rast, kjo barasvlerë plotësohet nëse merrni 80 përqind të pagës tuaj për të paktën 720 ditë dhe nëse ndërmarrja juaj paguan gjysmën e premisë.

12 maj: Personeli i kujdesit në rrugë

Infermiera është thelbësore për funksionimin e shoqërisë sonë

Më 12 maj, me rastin e ditës ndërkombëtare të infermierisë janë zhvilluar manifestime të shumta: Në një dizinë qytetesh zvicerane personat e besuar sindikalist të kujdesit organizuan aksione, për të tërhequr vëmendjen për infermierinë. Pasi pa përmirësimin e kushteve të punës cilësia e kujdesit nuk do të mund të garantohej më tej

Enrico Borelli, drejtues i sektorit terciar

Pjesëmarrësit drejtuan një apel urgjent në organet politike dhe punëdhënësit: çdo muaj 300 infermierë largohen nga profesioni, kushtet e punës në sektorin e kujdesit janë të paqëndrueshme dhe stafi është në kufirin e ngarkesës së tyre fizike dhe mendore.

Andaj, nisma për infermieri të fuqishme, e cila nëntorin e shkurtit u aprovua nga popullata, duhet të zbatohet sa më shpejtë. Paralelisht me këtë duhet që federata, kantonet dhe punëdhënësit urgjentisht të ndërmarrin masa, për të përmirësuar kushtet e punës dhe për të mënjeluar mungesën akute të personelit.

Ne gjendemi në situata paradokse: Infermiera është thelbësore për funksionimin e shoqërisë sonë – pasi të gjithë ne, herë do kur gjatë jetës sonë do të jemi të varur nga kujdesi i mirë. Popullata e ka kuptuar këtë, prandaj ka aprovuar dukshëm nismën. Mirëpo autoritetet dhe forcat më të rëndësishme politike nuk janë duke un përpjekur për zbatim të shpejtë dhe të plotë të nismës së aprovuar. Ata luajnë me kohën dhe nuk marrin seriozisht kërkesat

e theksuara nga personeli dhe të aprovuara nga popullata votuese. Në situatë të tillë vuajnë kujdestarët, familjet e tyre dhe së fundi edhe pacientët edhe pacientet.

Prandaj është e nevojshme të shumëfishohen momentet e mobilizimit, të nxitet

procesi i solidaritetit kolektiv, për të rritur prezencën e sindikatave dhe për të promovuar diskursin e vërtetë social në interes të infermierëve, pacientëve dhe të gjithë popullatës. Ne do të vazhdojmë të angazhohemi më tej.



Pamje nga një aksion i organizuar sindikalist me rastin e ditës ndërkombëtare të infermierisë

Dita e sindikatës dhe festa e Unia e regjionit Cyrih-Shafhauzen Xhafer Sejdiu zgjidhet kryetar regjional i Unia Cyrih-Shafhauzen

Unia e regjionit Cyrih-Shafhauzen me 13 maj 2022 në Cyrih ka zhvilluar Ditën e Sindikatës. Dita e Sindikatës zhvillohet çdo dy vjet dhe është dita kur regjioni zgjedh organet e tij më të rëndësishme dhe diskuton të ardhmen e sindikatës. Pas pjesës së ditës së sindikatës ku prezantohet edhe raporti i aktiviteteve për dy vitet e fundit bashkë me qëllimet për të ardhme si dhe votohen organet vendimmarrëse, pjesëmarrësit festojnë ditën e sindikatës Unia!

Osman Osmani

Unia e regjionit Cyrih-Shafhauzen është ndër regjionet më të rëndësishme dhe më numerike me anëtarë të sindikatës Unia. Pas raportit të aktiviteteve u zhvilluan edhe votimet për organet e Unia për dy vitet e ardhshme me ç' rast anëtarët zgjedhën edhe delegatët regjional, kryesin dhe kryetarin e nënkryetaren e Unia regjioni Cyrih-Shafhauzen.

Në ditën e sindikatave, anëtarët e Unia Cyrih-Shafhauzen zgjedhën përfaqësuesit e tyre në kryesinë regjionale, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e strategjinë regjionale dhe drejtimin e zbatimit të strategjisë. Gjithashtu zgjidhet edhe Asambleja regjionale e delegatëve, e cila vendos për objektivat vjetore dhe buxhetin si dhe vendos për strategjinë. Asambleja pra vendos se çfarë do të bëhet në Unia të regjionit Cyrih-Shafhauzen. Në Ditën Sindikale u bë edhe bilanci për dy viteve të fundit dhe u fol për mënyrën se si mund të përballohen sfidat e së ardhmes.

Paraqitje dinjitoze e aktivistëve sindikalist shqiptarë

Me rastin e prezantimit të aktiviteteve dhe grupeve aktive në kuadër të regjionit të sindikatës Unia Cyrih-Shafhauzen, kolegu e bashkëkombësi i ri i grupit të aktivistëve shqiptarë, Kristjan Gjenci prezantoi grupin aktivistëve shqiptar dhe aktivitetet e bujshëm të grupit në dy vitet e kaluara dhe planifikimin e aktiviteteve të grupit për svinjet.

Aktivisti shqiptar Xhafer Sejdiu zgjidhet kryetar i sindikatës Unia të regjionit Cyrih-Shafhauzen

U zgjodh kryesia e re regjionale me në krye, kryetarin Xhafer Sejdiu, ndërsa nënkryetare u zgjodh kolegia Elina Falchi-Ender. Më pas u votua edhe për kryesinë regjionale me ç' rast krahas kolegeve



e kolegeve tjerë, delegatët për kryesi ndër të tjerë nga komuniteti ynë zgjedhën kolegen e bashkëkombësen tonë, Remzije Rashiti.

Kryetari i rizgjedhur, Xhafer Sejdiu ka qenë deri tani anëtar i kryesisë rajonale. Xhaferi është i përfshirë në grupin e aktivistëve shqiptarë, në grupin e ndërtimit, në grupin aktiv@unia dhe në grupin i interesit të migracionit. Ai është nominuar nga grupi i aktivistëve shqiptarë, grupi i ndërtimit, grupi aktiv@unia dhe grupi i interesit të emigracionit. Në fjalën e tij zgjedhore ai theksoi: «Dua të angazhohem në kryesinë rajonale sepse dua të mbështes politikisht organizatën tonë për të përmirësuar kontratat kolektive të punës. Këtë vit Kontratës sonë të Kombëtare të Punës në ndërtimtari (KKP) po i vjen fundi, ndaj dua të angazhohem edhe më shumë për një kontratë më të mirë kolektive në sektorin e ndërtimit.»

Delegatët e zgjedhur nga radhët e aktivistëve shqiptarë

Delegate regjional, krahas delegatëve tjerë të sindikatës Unia për regjionin Cyrih-Shafhauzen, nga radha e bashkëkombëseve tanë u zgjedhën e rizgjedhën aktivistet e aktivistët e sindikatës nga grupi shqiptarë: Zarije Bajrami, Ramis Alili, Kristjan Gjenci, Naim Krasniqi dhe Osman Osmani.